



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË**

DREJTORIA E FINANCËS

Relacion

Mbi miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024

Në zbatim të ligjit nr. 9936 datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të ligjit nr. 68 datë 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimit nr. 23 datë 30.7.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore”, si dhe udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 7 date 26.2.2021 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2022-2024”, Bashkia Korçë ka përgatitur materialin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024.

Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) është një instrument për prezantimin në mënyrë të integruar e disa vjecare të parashikimit të të ardhurave dhe burimeve financiare publike dhe për planifikimin, manaxhimin dhe lëvrimin e shërbimeve publike. Si i tillë, ai është një komponent kryesor i planifikimit kombëtar dhe vendor.

Procesi i PBA-së, prezanton në mënyrë të integruar informacionin mbi parashikimet e të ardhurave dhe burimeve gjithsej dhe përcakton objektivat përse do të shpenzohen ato, kostot e nevojshme dhe llojin e secilit shërbim që do të ofrohet. Ndër të tjera, kjo përfshin lidhjen e qëllimeve dhe objektiveve të bashkisë me qëllime strategjike të përcaktuara në strategjitë lokale dhe kombëtare. Procesi i PBA-së, disiplinon maturinë financiare vendore duke planifikuar shpenzimet publike brenda një kuadri realist financiar vendor. Në të njëjtën kohë, ai synon të garantojë që shërbimet publike vendore plotësojnë nevojat në rritje të banorëve, duke treguar se si shpenzimet publike për prioritetet strategjike të zhvillimit të njësive vendore, përkthehen në vendime konkrete për ofrimin e shërbimeve publike vendore, me lidhje të qarta mes politikave vendore dhe prioritetëve vjetorë të shpenzimeve.

Në procesin e PBA-së planifikimi dhe buxheti vendor afatgjatë e ndihmon njësine vendore të planifikojë, se si shërbimet publike do të evoluojnë me kalimin e kohës, duke përcaktuar kërkesat disavjeçare të shpenzimeve në fusha të ndryshme të ofrimit të shërbimeve, në përputhje jo vetëm me ndryshimet e parashikuara në demografinë, por edhe në përputhje me ndryshimin e nevojave të banorëve të bashkisë. Kombinimi i këtij informacioni me parashikimin për nevojat dhe burimet në dispozicion në të ardhmen, u mundëson njësive vendore që të planifikojnë shërbime publike në mënyrë të qëndrueshme, si dhe të zhvillojnë një kuadër afatmesëm të burimeve, si bazë për planifikimin afatmesëm të shpenzimeve. Gjithashtu, procesi i PBA-së siguron një kornizë për planifikimin e investimeve publike sipas programeve buxhetore duke përfshirë edhe kërkesat për shpenzimeve korrente. Kjo siguron një bazë të fortë mbi të cilën mund të merren vendimet për investime, të lidhura me planet strategjike dhe planet afatmesme për zhvillimin e shërbimeve të ndryshme publike që njësia vendore ofron për banorët.

Në mënyrë të përmbledhur Programi Buxhetor Afatmesëm përfshin këto procese:

- prezanton informacionin mbi të ardhurat dhe burimet e disponueshme të bashkisë;

- përkthen vizionin strategjik të NJVQV-së në plane praktike për ofrimin e shërbimeve gjatë një periudhë disavjeçare;
- shpërndan burimet sipas fushave të veçanta të ofrimit të shërbimeve publike,
- përcakton treguesit e performancës në secilën fushë të ofrimit të shërbimeve;
- llogarit kërkesat vjetore të shpenzimeve (korrente dhe për investime) në përputhje me objektivat dhe treguesit e performancës për një periudhë disavjeçare; dhe
- përcakton treguesit vjetorë të performancës në përputhje me parashikimet për burimet në dispozicion përgjatë një periudhe disa vjeçare.

Theksojmë se në zbatim të Udhëzimit nr. 7 datë 26.2.2021 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2022-2024’ pika 9, Bashkia Korçë përgatiti dokumentin e PBA 2022-2024 dhe e depozitoi atë pranë MFE, brenda datës 1 qershor 2021.

Burimi i informacionit: Nxjerrë nga Instrumenti i Planifikimit Financiar

Në tabelën e mëposhtme jepet totali i burimeve të buxhetit, shpenzimet e përgjithshme dhe fondi rezervë dhe fondi i kontigjencës.

(F13) STATISTIKA FINANCIARE TË PËRGJITHSHME

	2019	2020	2021	2022	2023	2024
TOTALI I BURIMEVE TË BUXHETIT						
Burimet e përgjithshme të buxhetit	2,402,810	2,133,249	1,926,862	1,712,039	1,751,640	1,793,362
TOTALI I SHPENZIMEVE						
Shpenzimet e përgjithshme	2,248,772	1,997,576	1,926,652	1,709,039	1,748,151	1,789,787
TOTALI I FONDEVE REZERVE + KONTIGJENCË						
TOTALI I FONDEVE REZERVE + KONTIGJENCË				3,000	3,488	3,573
FITIMI / HUMBJA E PËRGJITHSHME						
Përfitimi (+)/ Humbja (-) e përgjithshme	154,038	135,673	-	0	1	2

Pas miratimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore me VKB nr. 9 datë 29.1.2021 “Për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave, u përgatitën tavanet e shpenzimeve sipas programeve, të cilat u miratuan me VKB nr. 32, datë 25.03.2021, “Për miratimin e tavanëve përfundimtare të shpenzimeve për Programin Buxhetor Afatmesëm 2022-2024, në nivel programi”.

Detajimi i buxhetit, do të jetë në të njëjtat nivele sipas tavanëve të miratuara sipas VKB të sipërpërmëndur.

Të ardhurat e Bashkisë Korçë për 3 vitet e ardhshme buxhetore 2022-2024 paraqitet si më poshtë:

Burimet e financimit

1. Të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore

000/lekë

	Të ardhurat	2022	2023	2024
A.	Nga burimet e veta	894,194	902,907	911,683
	Të ardhurat nga taksat vendore	442,082	446,503	450,968
	Të ardhurat nga tarifatat vendore	394,997	398,947	402,936
	Të ardhura të tjera	57,115	57,457	57,779
B	Nga buxheti qendror	817,845	848,733	881,679
	Total (A+B)	1,712,039	1,751,640	1,793,362

2. Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme

Sipas Udhëzimit nr. 7 datë 26.2.2021 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2022-2024, madhësia e transfertës së pakushtëzuar është 1% e PBB-së të viteve 2022-2024.

Kriteret dhe koeficientët e formulës së shpërndarjes së transfertës së pakushtëzuar për vitet 2022-2024 do të jenë sipas përcaktimeve në nenin 24, ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”. Në përllogaritjen e formulës së transfertës së pakushtëzuar për vitin 2021, kriteret e përdorurara dhe ato që do të përdoren për PBA-në 2022-2024 janë: popullsia (harmonizim midis të dhënave të regjistrit të gjendjes civile dhe censusit), dendësia e popullsisë për km², numri faktik i nxënësve në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme në çdo bashki. Madhësia e koeficientëve dhe të dhënat e nevojshme për llogaritjen e formulës së shpërndarjes së transfertës së pakushtëzuar për vitet 2022-2024 do të jenë në përputhje me përcaktimet e Ankesit 1, të ligjit vjetor të buxhetit.

Vlera e planifikuar e transfertës së pakushtëzuar sektoriale e vitit 2022 do të jetë në të njëjtin nivel me vitin 2021, për vitin 2023 ka një rritje prej 30,888 mijë lekë ose ka një rritje 6.8% dhe për vitin 2024 krahasuar me vitin 2023 ka një rritje prej 32,946 mijë lekë ose me një rritje prej 6.8% dhe konkretisht:

2021	452,393 mijë lekë
2022	452,393””
2023	483,281 “”
2024	516,227 “”

3. Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale

Të ardhurat nga transferta e pakushtëzuar sektoriale për periudhën afatmesme komunikohen nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë përmes Udhëzimit Vjetor dhe atij Plotësues të Përgatitjes së PBA-së.

Sipas Udhëzimit nr. 7 datë 26.2.2021 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2022-2024, transferta e pakushtëzuar sektoriale parashikohet në programin buxhetor afatmesëm 2022-2024, për financimin e shpenzimeve për funksionet e transferuara tek bashkitë në vitin 2016. Sipas akteve ligjore në fuqi funksionet e transferuara janë: personeli mësimor dhe jomësimor në arsimin

parashkollor dhe personeli jomësimor në arsimin parauniversitar, ujitja dhe kullimi, shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi (PMNZSH), administrimi i pyjeve, mirëmbajtja e rrugëve rurale, konviktet e arsimit parauniversitar, qendrat e shërbimeve sociale. Parashikimi i zërave të pagave, sigurimeve shoqërore, shpenzimeve operative e të mirëmbajtjes, shpenzimeve për investime do të bëhen ne përputhje me aktet ligjore në fuqi për zërat përkatës. Bashkitë mund të shtojnë fonde nga të ardhurat e tyre për të rritur cilësinë e shërbimit për çdo funksion të transferuar.

Ndarja e transfertës së pakushtëzuar sektoriale sipas njësive të vetëqeverisjes vendore për periudhën 2022-2024 do të jetë në të njëjtat nivele me ndarjen e transfertës së miratuar me buxhetin e vitit 2021 dhe konkretisht:

/lekë

Transferta e pakushtëzuar sektoriale Arsimi Parashkollor	176,636,922
Transferta e pakushtëzuar sektoriale Konviktet e Arsimit Parauniversitar	21,881,368
Transferta e pakushtëzuar sektoriale Arsimi Parauniversitar	18,838,123
Transferta e pakushtëzuar sektoriale Rrugët Rurale	6,521,307
Transferta e pakushtëzuar sektoriale Ujitja dhe Kullimi	45,736,667
Transferta e pakushtëzuar sektoriale Mbrojtja nga Zjarri dhe Shpëtimi	29,964,338
Transferta e pakushtëzuar sektoriale Administrimi i Pyjeve	15,196,663

2. Plani i Shpenzimeve të Bashkisë Korçë për periudhën 2022-2024

Në tabelën e mëposhtme paraqiten shpenzimet aktuale, të buxhetuara dhe të planifikuara të Bashkisë mbi baza vjetore për secilën kategori ekonomike të shpenzimeve gjatë periudhës 2019 deri në 2024 .

Shpenzimet totale të Bashkisë sipas llogarive ekonomike.

000/lekë

PBA 2022-2024								
Raport	Shpenzimet Totale të Bashkisë sipas Kategorive Ekonomike							
Bashkia Korçë								
Shpenzimet e Bashkisë (000 ALL)								
Emri i Artikullit	Kodi i Artikullit	2019	2020	2021	2021	2022	2023	2024
		Fakt	Fakt	Buxh. Fillest.	Pritshme	Plani	Plani	Plani
Paga dhe Sigurime								
Paga	600	521,624.0	528,838.0	619,723.0	627,942.0	640,038.0	644,666.0	649,881.0
Sigurime Shoqërore & Shëndetësore	601	86,475.0	88,419.0	103,547.0	104,078.0	106,205.0	107,421.0	108,198.0
Korente								
Mallra dhe Shërbime	602	486,305.0	453,328.0	602,531.0	675,644.0	598,274.0	612,354.0	646,214.0
Subvencion	603	9,999.0	5,349.0	10,000.0	10,000.0	10,000.0	10,000.0	10,000.0
Transferta të Brendshme	604	78,910.0	84,485.0	127,124.0	152,944.0	152,000.0	152,000.0	152,000.0
Transferta të Jashtme	605	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Principal	166	47,995.0	47,906.0	43,850.0	43,850.0	43,210.0	41,854.0	42,830.0
Interes	651	5,764.0	4,775.0	3,700.0	3,700.0	2,590.0	1,556.0	580.0
Transferta për Familje & Individë	606	529,948.0	616,776.0	23,395.0	23,606.0	24,000.0	24,000.0	24,000.0
Shpenzime Kapitale								
Aktive të Paprekshme	230	397.0	0.0	10,000.0	10,000.0	8,000.0	8,000.0	8,000.0
Aktive të Prekshme	231	481,355.0	16,770.0	133,287.0	275,098.0	127,722.0	149,789.0	151,659.0
TOTALI		2,248,772.0	1,997,576.0	1,677,157.0	1,926,862.0	1,712,039.0	1,751,640.0	1,793,362.0

Gjithashtu Bashkia Korçë ka planifikuar fond rezervë dhe fondin e kontigjencës si më poshtë:

000/lekë

Nr.	Emërtimi	2022	2023	2024
1	Fondi rezervë	2,000	2,488	2,573
2	Fond i kontigjencës	1,000	1,000	1,000
	Total	3,000	3,488	3,573

Kërkojmë nga Këshilli Bashkiak miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024, në zbatim të ligjit 9936 datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 68 datë 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimit nr. 23 datë 30.7.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore”, si dhe udhëzimit të MFE nr. 7 date 26.2.2021 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2022-2024”.

Bashkangjitur relacionit:

1. Formati F1, “Parashikimi i burimeve të të ardhurave të njësisë së vetëqeverisjes vendore” për periudhën 2022-2024.
2. Formati F6 “Shpenzimet sipas nënfunksionit dhe programit – vlera bruto” për periudhën 2022-2024.
3. Formati F15 “Shpenzimet kapitale sipas programeve” për periudhën 2022-2024.

DREJTORE E DREJTORISË

SË FINANCËS

VALBONA ZIKO

DREJTOR I DREJTORISË

SË TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE

SONIEL PRIFTI

DREJTORE E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME

JURIDIKE DHE TË MENAXHIMIT

TË BURIMEVE NJERËZORE

ANXHELA DISHNICA

KRYETARI I BASHKISË

SOTIRAQ FILO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

P/VENDIM

Nr. _____ Datë _____

Mbi miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2022-2024

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi mori në analizë materialin e paraqitur nga Drejtoria e Financës duke u bazuar në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 68 datë 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore, Udhëzimin nr. 23 datë 30.7.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore”, udhëzimin e MFE nr. 7 datë 26.2.2021 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2022-2024”, mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimeve dhe propozimeve të këshilltarëve:

VENDOSI

4. Të miratojë programin buxhetor afatmesëm 2022-2024, të përgatitur sipas Instrumentit të Planifikimit Financiar.
5. Të miratojë të ardhurat e Bashkisë Korçë sipas formatit F1, “Parashikimi i burimeve të të ardhurave të njësisë së vetëqeverisjes vendore” për periudhën 2022-2024.
6. Të miratojë shpenzimet e Bashkisë Korçë sipas formatit F6 Shpenzimet sipas nënfunksionit dhe programit – vlera bruto për periudhën 2022-2024.
7. Të miratojë shpenzimet për investime të Bashkisë Korçë sipas formatit F15 Shpenzimet kapitale sipas programeve për periudhën 2022-2024.
8. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ekzekutivi i Bashkisë Korçë.
9. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Erjon Nexhipi